

QENDRA SHITETËRORE E PROVIMEVE

PROGRAMI I PROVIMIT PËR DETYRË PROJEKTUESE

(përktheu: Liridon Sulejmani, mësimehënës pranë SHMK “ISMET JASHARI” – LIKOVË)

1. HYRJE

Sipas **Konceptit për maturë dhe për provim përfundimtar në shkollë të mesme publike**, nxënësit në fund të shkollës së mesme katër vjeçare i nënshtrohen provimit me të cilin duhet të dëshmojnë gatishmërinë për vazhdimin në mënyrë të pavarur të jetës së tyre personale dhe profesionale.

Në arsimin gjimnazor nxënësit i nënshtrohen provimit të maturës shtetërore ose shkollore; në shkollë të mesme profesionale – maturë shtetërore ose provim përfundimtar, ndërsa në shkolla të mesme artistike – shtetërore ose shkollore.

Të gjitha këto modele të provimeve, përveç pjesës zgjedhore dhe obligative, përmbajnë edhe detyrën projektuese e cila është pjesë përbërëse e provimeve. Ajo nënkupton se nxënësit nga shkolla e mesme katërvjeçare, pavarësisht se a do ta kalojnë maturën shtetërore, maturën shkollore apo provimin përfundimtar, janë të detyruar për përgatitje të detyrës projektuese

Nxënësi e përgatit detyrën projektuese në mënyrë të pavarur dhe mban procesverbal/portfolio. Detyra projektuese përbëhet nga studimi i një problemi konkret të cilin nxënësi e zgjedh nga ndonjë (disa) lëndë mësimore apo nga fusha më të gjera mësimore nga vullneti dhe interesi i tij i lirë.

PRINCIPET MBI TË CILAT DUHET TË BAZOHET DETYRA PROJEKTUESE

Parimet që duhet t'i ndjekin nxënësit detyrimisht gjatë realizimit të detyrës projektuese janë:

- parimi i origjinalitetit (nxënësi duhet në mënyrë të pavarur të zgjedhë dhe t'a punojë detyrën projektuese)
- parimi i kreativitetit (gjatë përpunimit të detyrës projektuese, nxënësi duhet të përdorë shpirtin krijues dhe zbulues)
- parimi i autenticitetit (detyra projektuese duhet të jetë e bazuar në ide dhe koncepte personale dhe origjinale të artikuluar me gojë dhe me shkrim, me formulim gjuhësor të qëndrueshëm, me qartësi akademike dhe me kujdes deri në fund të ruajtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale),
- parimi i etikës (gjatë përpunimit të detyrës projektuese nxënësi duhet të udhëhiqet nga kategoritë etike bazë: vërtetësia, ligjësitë, qartësia, zbatueshmëria dhe dobia),
- parimi i shkencës (të ketë elemente të punës hulumtuese shkencore)

Nxënësi duhet të jetë i sigurtë se rreth problemit të hulumtuar të detyrës projektuese ekzistojnë njohuri shkencore të provuara në korniza të shkencës së dhënë, disiplinave shkencore dhe shkenca përkatëse.

- të ketë ndikim në mjedisin ku nxënësi jeton (p.sh mjedisi jetësor, mjedisi social, etj me fjalë tjera të shkaktojë ndryshime pozitive)
- të promovojë vlera pozitive
- të përfshijë elemente të punës aktive, humane, vullnetare

- të përpunohet me përdorimin e formave dhe teknikave bashkëkohore të prodhimit dhe komunikimit, me mjete bashkëkohore të platformave të komunikimit, si dhe duke shfrytëzuar multimedia në mënyrën e shprehjes së detyrës projektuese

2. QËLLIMET E DETYRËS PROJEKTUESE

Detyra projektuese do të inkurajojë te nxënësit kreativitetin, imagjinatën, inovacionin, shpirtin krijues dhe zbulues. Do të zhvillojë tek nxënësit: dashurinë ndaj kureshtjen natyrore, shpirtin kritik, parimin dhe ndershmërinë, ndjenjën e së drejtës, empatinë, simpatinë dhe të kuptuarit e nevojave të të tjerëve, shkathësitë për udhëheqje të procedurave të hulumtimit (hulumtim të koncepteve, temave dhe ideve) të cilat kanë kuptim lokal dhe global. Do të aftësojë nxënësit për njohje dhe zgjidhje të problemeve dhe ndërtim të sistemeve vlerore të bazuara në vendime racionale dhe etike me qëllim të kryerjes së ndryshimeve pozitive.

Me detyrën projektuese do të provohet se nxënësi a di dhe a mund të:

- të identifikojë, studiojë dhe hulumtojë një problem konkret
- të shfrytëzojë sipas rregullave burime të informacionit dhe të teknologjisë informatike gjatë studimit
- të shfrytëzojë metodologji të përshtatshme gjatë punës së hulumtimit
- të argumentojë, të përfundojë në mënyrë logjike, të vlerësojë dhe të prezantojë të dhëna nga hulumtimi i një problemi (eksperimenti)
- të planifikojë dhe të kryejë eksperiment:
- të projektojë zgjidhje të përshtatshme për përpunim të një produkti/krijimi/shfaqje skenike apo të kryejë shërbime të ndara
- të ndërmarë aktivitete humanitare dhe vullnetare, aktivizëm qytetar
- të kryejë detyra nga fusha e profilit arsimor (të përpunojë ndonjë prodhim apo të realizojë ndonjë qëllim i cili vlen në tregun e punës)
- të kryejë faza të ndara të procesit të punës, të veprojë me paisjet, objektet e punës, të zbatojë procedurat e kryerjes së një procesi
- të përgatisë dokumentacion, të udhëheqë evidencë, të përpunojë plane, bilance dhe llogaritje, të formojë akte zyrtare, letra biznesi, kontrata, vendime dhe raporte
- Të plotësojë dhe formojë modele e dokumente të tjera

3. LLOJET STANDARDE TË DETYRËS PROJEKTUESE

Ka katër lloje të standardizuara të detyrës projektuese, edhe atë:

- detyrë projektuese – prodhim/krijim/performancë/ngjarje
- detyrë projektuese – ese
- detyrë projektuese – raport nga hulumtimi empirik
- detyrë projektuese – raport nga hulumtim eksperimental

Provimi në lidhje me detyrën projektuese përbëhet nga:

- pjesa me shkrim dhe pjesa me gojë ose
- pjesa me shkrim, pjesa praktike dhe pjesa me gojë

Pjesa me shkrim përfshin të gjitha materialet e shkruara të cilat nxënësi i përgatit gjatë fazës së parë dhe të dytë të detyrës projektuese. Kjo pjesë duhet të jetë:

- e përgatitur me cilësi teknike (e punuar me kompjuter në format A-4, me madhësi të fontit 12, me hapësirë ndërmjet rreshtave 1.5)
- në gjuhë standarde, me stil dhe terminologji të përshtatshme
- Me shkrim sipas rregullave dhe me përdorim korrekt të vërejtjeve, fusnotave dhe literaturës së shfrytëzuar gjatë hulumtimit

Pjesa me gojë e detyrës projektuese, është vetë prezantimi (mbrojtja) e detyrës projektuese. Ajo duhet të jetë e shkurtë, e qartë, e mbështetur në argumente, logjikë, e përgatitur sipas kompozimit të rrëfimit me gojë. Ajo përbëhet nga tri pjesë: hyrja, pjesa kryesore dhe përfundimi.

Në pjesën hyrëse nxënësi i jep informacionet e përgjithshme (bazë) të temës, sqaron çka e ka motivuar që të zgjedhë problemin e caktuar të hulumtimit.

Në pjesën kryesore nxënësi spjegon qartë dhe në mënyrë precize pyetjen/pyetjet e hulumtimit.

Në pjesën përfundimtare nxënësi i prezenton vëzhgimet përfundimtare

Pas prezantimit, anëtarët e komisionit (përpos mentorit) kanë të drejtë nxënësit ti parashtrojnë pyetje.

Prezantimi (mbrojtja) e detyrës projektuese nuk duhet të zgjasë më gjatë se **20 minuta**, duke përfshirë edhe kohën për pyetje dhe përgjigje.

Pjesa praktike e detyrës projektuese i përfshin të gjitha aktivitetet të cilat i realizon nxënësi me qëllim që të tregojë aftësitë praktike të punimit të një produkti/krijimi. Kjo veçanërisht vlen për nxënësit të cilët kanë përzgjedhur detyrë projektuese në elektro-teknikë, makineri, bujqësi-veterinari, tekstil-lëkurë, ndërtimtari-gjeodezi, drejtimi i komunikacionit, procesi i prodhimit apo arti figurativ ose muzikor.

3.1 Detyra projektuese – prodhim/krijim

Përmes këtij lloji të detyrës projektuese nxënësi duhet të tregojë sa ka aftësi praktike për kryerje të punëve me dobi shoqërore, sa është i aftë të promovojë vlera pozitive dhe humane, si dhe të kryejë punë nga fusha e profilit arsimor për të cilin është përgatitur. Rezultati përfundimtar i këtij lloji të detyrës përpunohet si **prodhim/krijim** konkret i cili mund të jetë:

- **punim me shkrim ose digjital**
- **performancë/iniciativë/ngjarje që sjell ndonjë ndryshim**
- **prodhim nga material konkret**

Krijim digjital llogariten platformat digjitale (gazetë elektronike apo profil tematik) të cilët përpunojnë përmbajtje kreative dhe mësimore nga fusha e gjuhës, kulturës, artit, shkencës, nga mënyra bashkëkohore e jetesës dhe sjelljes qytetare në mjedisin jetësor etj. Përmbajtjet mund të jenë videomateriale, filma të shkurtër, storie gazetareske të ndonjë teme të caktuar, portrete të personaliteteve të rëndësishme së veçantë për mjedisin, kampanja etj. Çdo nxënës që përpunon punim digjital duhet të përgatisë edhe dokument të shkurtër me shkrim (tekst të shkruar) në (5) faqe i cili përmban:

- hyrje të shkurtë që përshkruan: cila është nevoja, rëndësia, funksioni i krijimit të punuar (dobia dhe justifikimi shoqëror , kuptimi tekniko-teknologjik i krijimit);
- pjesa kryesore e cila përmban: përshkrim të shkurtër të krijimit, mënyrën në të cilën është planifikuar dhe organizuar aktiviteti dhe përpunimi i saj, tregim i skicave dhe skemave të përdorura, zgjedhja e materialeve; zgjedhja e të dhënave, specifikimi i paisjeve të shfrytëzuara gjatë përpunimit të krijimit; tregim profesional të procesit të përpunimit; struktura dhe tregimi i produktit përfundimtar/krijimit
- pjesa përfundimtare në të cilën nxënësi: i paraqet njohuritë e tij, përfundimet e tij, komente në lidhje me detyrën projektuese, i tregon vështirësitë eventualeme të cilat ai ballafaqohet gjatë punimit të tij;
- literaturën e shfrytëzuar: renditet literatura (sipas rregullave)

Punim me shkrim më së shpeshti e punojnë nxënësit nga drejtimi ekonomiko-juridik dhe tregtar apo hotelieriko-turistik. Mund të paraqitet në formë të: zgjidhje e projektuar për punim të ndonjë prodhimi konkret apo për kryerje të shërbimit të veçantë, lloj dokumenti, evidence, plane të llojeve të ndryshme (p.sh biznes plan), bilance, llogaritjet, akte zyrtare, modele.

Struktura e punimit me shkrim është shumë e ngjajshme me strukturën e raportit. Duhet të jetë e qartë dhe konceptive, të fotografojë idejën e zgjidhjes së detyrës, t'i komunikojë: procedurat, rezultatet, përfundimet dhe komentet e nxënësit në lidhje me detyrën. Së paku duhet të ketë 12 faqe tekst i shkruar.

Me detyrën projektuese – performancën/inciativë/ngjarje provohen njohuritë dhe aftësitë e nxënësit për:

- krijimi i iniciativave që shkaktojnë ndonjë ndryshim (trajnim për arritjen e shkathësive të caktuara, aktivitete vullnetare, eko-aksione, aktivitete humanitare dhe ndihmë të kategorive në nevojë dhe të ngjajshme.);
- performime dhe procedura të ndërlidhura me faza të caktuara të procesit të punës
- organizimi i shfaqjeve skenike dhe artistike (dramë, lexim literature, mbledhje oratorie, ekspozitë, ngjarje multimediale).

Nxënësi është i detyruar të përgatisë dhe dokumentacion me shkrim (tekst të shkruar) në (5) faqe që përmban:

- **planin aksionar** në të cilin e sqaron temën, e definon pyetjen e hulumtuar, jep përshkrim të shkurtër të përmbajtjes së detyrës projektuese, i definon qëllimet, i përcakton burimet e nevojshme për realizimin e saj, njofton bashkëpunorë, definon afatet kohore të realizimit të detyrës projektuese (kush, cili, kur ku do t'i bëjë). Plani aksionar mund të jetë i përpunuar në formë të tabelës.
- **raport i shkurtër me shkrim** në të cilin nxënësi sqaron cili ka qenë motivi që ai ka zgjedhur temën e kësaj (pyetjen e hulumtimit) të detyrës projektuese, i përshkruan fazat e realizimit të tij dhe i paraqet rezultatet dhe efektet pozitive të performancës/inciativës/ngjarje.
- **bashkangjitje.** Ato janë tekste, fotografi, broshura, postera, linqe të përdorura, video përshkrime, vërtetime nga njerëz profesional, institucione dhe organizata dhe dokumente të llojeve të tjera që dëshmojnë se nxënësi në mënyrë të pavarur e ka punuar detyrën projektuese (ka kryer aktivitet të caktuar vullnetar, humanitar dhe lloje të tjera të aktivitetit social). Pas realizimit të çdo aktiviteti, nxënësi është i detyruar bashkangjitjet t'ia dorëzojë mentorit. Në këtë mënyrë mentori do të mund të përcjellë dinamikën me të cilën nxënësi e përgatit detyrën projektuese dhe do të mund të kontrollojë besueshmërinë e tij.

Emri dhe mbiemri i nxënësit						
Emri i shkollës/klasa						
Lënda mësimore						
Emri i temës/problemi që hulumtohet						
Qëllimet e detyrës projektuese						
Aktiviteti	Qëllimi i aktivitetit	Bartësi	Bashkëpunëtori/Institucioni në të cilin zhvillohet aktiviteti	Afati	Burimet e nevojshme	Treguesi për kryerje me sukses të aktiviteti
1.						
2.						

Në kornizat e detyrës projektuese – **prodhimi i materialit konkret** nxënësi e përpunon lëndën, si shembull: pjesë elektronike apo makinerike, skulpturë, grafikë, vizatim, fotografi, pjesë të veshjes, orendi, ushqim etj. Ky lloj i detyrës projektuese më së shumti i përgjigjet nxënësve të shkollave të mesme profesionale, si dhe nxënësve të shkollave artistike.

Nxënësi që e punon detyrën projektuese – prodhim i materialit konkret, përgatit edhe **dokumentacion me shkrim** (tekst të shkruar) të (5) faqe e cila ka të njejtën strukturë si dokumentacioni i përgatitur në punim digjital.

3.2 Detyra projektuese – ese

Eseji është në formë e shprehjes me shkrim të cilin e përgatit nxënësi pas kryerjes së studimit të thelluar të temës konkrete nga ndonjë lëndë mësimore/fushë, ose nga ndonjë rishikim i ndonjë pyetjeje nga trendet bashkëkohore (kultura e të rinjëve, mjetet e komunikimit, stilet e jetës, vlera shoqërore) dhe pyetje të ngjashme aktuale që do të jenë lëndë e analizës. Në këtë mënyrë nxënësi-maturanti do të motivohet të hulumtojë tema aktuale nga jeta e përditshme, por edhe tema që kanë kuptim global.

Qëllimi është që nxënësi të aftësohet në mënyrë të pavarur të studiojë/hulumtojë, të shfrytëzojë informata në mënyrë të përshtatshme dhe logjike, të formojë qëndrime dhe reflektime të përshtatshme, por edhe të zhvillojë shprehi në të folur gjatë prezantimit të tij. Më së shpeshti gjatë hulumtimit shfrytëzohet gjuha amtare (maqedone, shqipe, turke), gjuhët e huaja (angleze, franceze, gjermane, ruse), gjuhët klasike, arti muzikor, sociologjia, filozofia, matematika, sporti dhe të ngjashme. Eseji përfshin procedura dhe teknika të të shkruarit të cilat janë në përputhje me nevojat e të shkruarit, por struktura nuk është gjithmonë e njejtë. Ajo përmban tri pjesë: hyrjen, pjesën kryesore dhe përfundimin. Në **hyrje** nxënësi:

- sqaron pse e ka zgjedhur temën (pse ajo është me interes dhe e rëndësishme për studim/hulumtim)
- qartë dhe në mënyrë precize e përcakton lëndën e studimit/hulumtimit (deri në çfarë gjerësie dhe thellësie e hulumton temën)
- jep vështrime përfundimtare nga hulumtimi i paraqitur se ato të dhëna do të jenë më në detaje të sqaruara në pjesën kryesore

Pjesa kryesore është e rëndësishë së veçantë. Në të nxënësi në mënyrë sistematike e zhvillon esejin duke dhënë përgjigje bindëse në pyetjet e studimit/hulumtimit. Struktura dhe procedurat që shfrytëzohen nga nxënësi në pjesën kryesore janë me ndarje të qartë. Ato varen nga natyra e lëndës mësimore/ fusha nga e cila është detyra projektuese. Ato i përcakton mësimdhënësi – mentori në marrëveshje me nxënësin. Në disa fusha të hulumtimit pjesa kryesore mund të përmbajë edhe nëntituj. Për shembull: gjatë hulumtimit të grupit të lëndëve natyrore, pjesa kryesore e esejit zakonisht përmban nëntituj në të cilët sqarohen metodat dhe teknikat e hulumtimit. Gjatë përpunimit të esejit duhet t'i largohet nëntitujve meqë ndërpresin vazhden e tërësisë së esejit.

Përfundimi duhet të përmbajë:

- përfundime të qarta dhe qëndrime të përshtatshme në pyetjen e parashtruar në fillim
- Dëshmi të mbështetura në fakte
- Rezultate bindëse dhe të rregulluara, eventualisht, pyetje të reja të cilat dalin nga studimi/hulumtimi

Eseji për nga vëllimi duhet të jetë **më së shumti me 10 faqe** (pa faqen kryesore, faqen ku është e paraqitur përmbajtja e esejit, skicat, fotografitë, diagramet, ilustrimet, tabelat, lista e literaturës së shfrytëzuar, shtojcat). Është e dëshirueshme që eseji të përmbajë abstrakt (syzhe) deri në 300 fjalë në të cilin nxënësi jep pamje të qartë të studimit/hulumtimit dhe rezultatet/përfundimet e fituara, me qëllim vlerësuesi shpejt të kuptojë përmbajtjen e esejit.

3.3 Detyra projektuese-raport nga hulumtimi empirik

Studimi/hulumtimi në korniza të detyrës projektuese, nxënësi e realizon me qëllim që në mënyrë të pavarur të përgjigjet në ndonjë pyetje, të zgjidh ndonjë dilemë apo të provojë ndonjë të vërtetë tashmë të vërtetuar nga ndonjë fushë profesionale konkrete. Për këtë arsye ato nuk kanë karakter mësimor, këtu nxënësi ka mundësi të arrijë aftësi hulumtuese, të praktikojë metodologjinë e punës kërkimore, të aftësohet për nxjerrje të pavarur të përfundimeve. Pas kryerjes së studimit/hulumtimit nxënësi është i detyruar të përgatisë raport.

Raportin nga hulumtimi/studimi i kryer nxënësi e përgatit me qëllim që ti tregojë komisionit cilin problem e ka hulumtuar, cilat rezultate i ka fituar dhe cilat përfundime i ka nxjerrur. Ai duhet të jetë i qartë, konciz dhe ai duhet të njoftojë gjithçka që është bërë dhe pse është bërë. Raporti për nga vëllimi duhet të përmbajë 12 faqe. Bashkëngjitet (shënimi i procedurave, fotografitë, dokumentacioni, shembuj të anketave dhe pyetësorëve etj) zakonisht jepen në fund të raportit.

Raporti përmban këto pjesë: **Hyrje, Metodrat dhe teknikat e shfrytëzuara gjatë hulumtimit, Rezultatet, Komente/Diskutim, Përfundimet, Literatura e shfrytëzuar**

Hyrja e detyrës projektuese nuk duhet të jetë më shumë se dy faqe. Në të nxënësi e prezanton problemin, njohuritë e njeriut rreth tij, arsyen për të cilën është hulumtuar, njohuritë e deritanishme që kanë çuar në atë problem të paraqitura në hulumtime të mëparshme, qëllimi i hulumtimit.

Në pjesën **Metodrat dhe teknikat** nxënësi sqaron si është kryer hulumtimit. E shënon planin e hulumtimit, procedurat dhe teknikat e mbledhjes së të dhënave. Ky kapitull mund të ndahet në nënkapituj, edhe atë: **Të anketuarit** (shënohen cilët dhe sa të anketuar kanë marrë pjesë në hulumtim dhe sipas cilit kriter janë përzgjedhur) dhe **Instrumentet dhe procedurat e matjes** (shënohen testet, pyetësorët, listat për vëzhgim dhe procedurat për marrjen dhe shfrytëzimin e të dhënave).

Në kapitullin **Rezultatet** nxënësi e prezanton dhe rezymon rezultatet nga analiza e të dhënave. Gjatë prezantimit të rezultateve nga analiza e të dhënave mund të shfrytëzojë tabela, grafike, fotografi të cilat duhet të jenë të numëruara dhe me titullim përkatës.

Në komente/diskutim nxënësi i interpreton rezultatet. Rezultatet e fituara i krahason me burimet nga literatura e shfrytëzuar përgjatë hulumtimit. Sipas këtyre rezultateve nxënësi duhet të konfirmojë apo ta hedh poshtë hipotezën e vendosur. Nxënësi, poashtu, duhet të kryejë lidhje të rezultateve të tij me ato të fituara nga ndonjë hulumtim i ngjajshëm i mëparshëm. Është e rrugës që ti shpjegojë edhe mangësitë e mundshme dhe problemet që ka hasur gjatë hulumtimit.

Në pjesën Rezume/Përfundime në mënyrë të shkurtë dhe të qartë e përshkruan problemin, metodologjinë e përdorur të punës dhe rezultatet (gjetjet) deri në të cilat ka arritur gjatë hulumtimit.

Të gjitha raportet nga hulumtimi i kryer, pavarësisht të cilit lloj janë, përmbajnë edhe listë të **literaturës së shfrytëzuar**. Ajo shënohet në verzionin origjinal, në gjuhën dhe shkrimin burimor, sipas rendit alfabetik sipas mbiemrit të autorit. Së pari shënohet mbiemri i autorit dhe iniciali i emrit,

viti kur është botuar punimi në kllapa, titulli i punimit, qyteti i shtëpisë botuese (nëse bëhet fjalë për artikull shënohet numri i revistës, numri i faqes dhe të ngjajshme.)

STRUKTURA E RAPORTIT NGA HULUMTIMI EMPIRIK

1. HYRJA

- Prezentohet problemi
- Sqarohen njohuritë dhe aktualiteti i problemit
- Shprehen njohuritë që kanë çuar deri në pranimë e problemit të hulumtimit që vijnë nga hulumtimet e mëparshme

2. METODAT DHE TEKNIKAT

- Përshkruhet plani i hulumtimit
- Përshkruhen procedurat dhe teknikat e kërkimit të të dhënave
- Përshkruhen cilët dhe sa të anketuar kanë marrë pjesë në hulumtim dhe sipas cilit kriter janë gjurmuar
- Sqarohen instrumentet matëse dhe procedurat (testet, pyetësorët, listat e vrojtimit) të cilat janë shfrytëzuar për përfitimin e të dhënave).

3. REZULTATET

- prezentohet dhe rezymohen rezultatet nga analiza e të dhënave (mund të shfrytëzohen tabela, grafikone, fotografi të cilat duhet të numerizohen dhe të titullohen në mënyrë të përshtatshme)

4. KOMENTET (DISKUTIMET)

- interpretohen rezultatet
- konfirmohet ose mohohet hipoteza e hulumtimit
- spjegohen rezultatet e fituara
- shënohen qëndrime të përshtatshme dhe mendime etj.

5. REZYME/PËRFUNDIME

- në mënyrë të shkurtër dhe koncize (të prerë) përshkruhet problemi, metodologjia e shfrytëzuar e punës dhe rezultatet (gjetjet)

6. LITERATURA E SHFRYTËZUAR

- përmendet literatura e shfrytëzuar dhe autorët (sipas rregulloreve)

STRUKTURA E RAPORTIT (TREGIMIT)

1. FAQJA E TITULLIT

- Shkolla, vendi
- Titulli i detyrës projektuese
- Fotografi/ilustrim nga i cili menjëherë mund të kuptohet qëllimi i eksperimentit
- Emri i nxënësit
- Emri i mentorit
- Data e mbrojtjes

2. HYRJE (PARATHËNIE)

- Lënda e hulumtimit (përshkrim i shkurtër i dukurisë, procesit, ligjeve që hulumtohen)
- Përshkrim i shkurtër historik i problemit, burimeve në të cilat ai është i trajtuar dhe nga kush (nëse ka të dhëna)
- Njohuritë dhe aktualiteti i problemit
- Qëllimet e hulumtimit
- Metodatat e hulumtimit
- Shënime të lëndëve dhe materialeve që janë përdorur gjatë eksperimentit

3. EKSPERIMENT DHE VROJTIM

- Skemat dhe tabelat me të dhënat nga përpjekjet
- Sqarim i detajuar i hulumtimit/eksperimentit
- Vizatime dhe prova nga monitorimi
- Metoda, kushte, shembuj

4. KOMENTET (DISKUTIMET)

- Të dhëna dhe burime nga literatura
- Skema, tabela
- Shpjegim, krahasime, reflektime

5. REZYME/PËRFUNDIME

- Vërejtje përfundimtare, pikëpamje, sugjerime për hulumtime të mëtejme

6. LITERATURA E SHFRYTËZUAR

- Njësitë bibliografike dhe autorët (sipas rregullave)

4. AFATET KOHORE TË PUNIMIT TË DETYRËS PROJEKTUESE

- Të zgjedhë dhe definojë temën (pyetjen e hulumtimit) në fillim të vitit të katër, ***më së voni deri në fund të nëntorit***
- Detyrën projektuese të përpunuar nxënësi duhet të ia japë mësimdhënësit-mentor ***më së voni deri në fund të muajit mars në vitin në të cilin i nënshtrohet provimit të maturës shtetërore***

5. FAZAT E DETYRËS PROJEKTUESE NGA ANA E NXËNËSIT (ESE)

1. Faza e përgatitjes

- E përzgjedh temën nga lënda mësimore/fusha e cila më së shumti i intereson; gjatë kësaj duhet të jetë i sigurtë se ka në punë e sipër mjaftueshëm burime të të dhënave dhe informacioneve në të
- Qartë dhe preciz e definon temën (i formulon pyetjet të cilat i studion/hulumton); mentori jep udhëzime se si nxënësi të hulumtojë
- Përcakton metodologjinë e punës
- Përgatit draft të esejës që duhet të përmbajë: skicë, vizatimet kryesore, detaje që do të ndihmojnë në përgatitjen e esesë; mbledhja e burimeve të të dhënave, përzgjedhja e të dhënave, bërja e analizës së të dhënave, rezymimi, formësimi i temës/esesë.

2. Faza e përpunimit/realizimit

- Përgatit verzionin e parë të esesë duke respektuar strukturën e saj
- E rishikon dhe rregullon esenë
- Jep esenë mentorit në lexim përfundimtar që të kontrollojë nëse esesa përmban të gjitha pjesët, se a janë bërë të gjitha korrigjimet
- Përgatit verzion përfundimtar të esesë

3. Faza e prezatimit

- Prezantimi i detyrës projektuese zhvillohet para komisionit tre anëtarësh dhe ai mund të jetë:
 1. Me gojë
 2. Kompjuteristik
 3. Poster
 4. Prezantim-portfolio
 5. Me kombinim teknikash

FAZAT E DETYRËS PROJEKTUESE NGA ANA E NXËNËSIT (RAPORT NGA HULUMTIMI EMPIRIK)

1. Faza e përgatitjes

- Nxënësi e zgjedh problemin e hulumtimit nga fusha e dhënë
- I definon qëllimet e hulumtimit
- Përgatit plan aksionar për realizimin e hulumtimit
- Në përputhje me natyrën e hulumtimit i definon dhe i shënon nënfazat dhe ndërfaqat
- Identifikon burime të të dhënave që do të shfrytëzohen gjatë hulumtimit

2. Faza e përpunimit/realizimit

- Zgjedh metodën e përshtatshme të hulumtimit
- Përgatit instrumentet e përshtatshme të realizimit të detyrës projektuese dhe të njejtat i shfrytëzon
- Mbledh dokumentacion për provat e kryera, studion, analizon, kryen përpunim statistik të të dhënave të kërkuara
- Nxjerr përfundime
- Përgatit raport sipas elementeve strukturore
- Zgjedh formë të prezantimit
- Kryen përgatitje (ushtrim) për rregullat dhe shfrytëzimin racional të kohës gjatë prezantimit
- Siguron teknikë të përshtatshme

3. Faza e prezatimit

- Prezantimi i detyrës projektuese zhvillohet para komisionit tre anëtarësh dhe ai mund të jetë:
 1. Me gojë
 2. Kompjuteristik
 3. Poster
 4. Prezantim-portfolio
 5. Me kombinim teknikash

FAZAT E DETYRËS PROJEKTUESE NGA ANA E NXËNËSIT (RAPORT NGA HULUMTIMI EKSPERIMENTAL)

1. Faza e përgatitjes

- Nxënësi e zgjedh problemin e hulumtimit nga fusha e dhënë
- I definon qëllimet e hulumtimit
- Përgatit plan aksionar për realizimin e hulumtimit në projektin në të cilin merr pjesë: metodat dhe teknikat e hulumtimit, kushtet-paisjet tekniko-materiale (aksesorë, aparate, instrumente, mjedise grafike, hemikale, materiale etj); lloji i dokumentacionit, dinamika e punës me afate; institucionet dhe ekspertët me të cilët bashkëpunon.
- Në përputhje me natyrën e hulumtimit i definon dhe i shënon nënfazat dhe ndërfaqet
- Identifikon burime të të dhënave që do të shfrytëzohen gjatë hulumtimit

2. Faza e përpunimit/realizimit

- Përgatit datotekë të përshtatshme (të dhënat e fituara i përzgjedh dhe i rregullon në papkëtë veçantë)
- Eksperimenton (E teston hipotezën apo hipotezat ndihmëse, me vazhdimsinë e paraparë sipas dokumentacionit)
- Vëzhgon
- Kryen matje dhe evidenton
- Rregullon, klasifikon dhe përpunon të dhëna
- Nxjerr përfundime
- E përcakton llojin e raportit/tregimit
- E mendon formën e prezantimit
- Kryen përgatitje (ushtrim) për rregullat dhe shfrytëzimin racional të kohës gjatë prezantimit
- Përgatit raport të detyrës projektuese

3. Faza e prezatimit

- Prezantimi i detyrës projektuese zhvillohet para komisionit tre anëtarësh dhe ai mund të jetë:
 1. Me gojë
 2. Kompjuteristik
 3. Poster
 4. Prezantim-portfolio
 5. Me kombinim teknikash

6. DETYRAT E MENTORIT

- Ti shikojë detyrat projektuese që ia japin nxënësit
- Të bashkëpunojë me komisionin e shkollës për maturë gjatë konfirmimit dhe pranimit përfundimtar të detyrës projektuese nga lënda e vetë
- Të përgatit orar për konsultime me nxënësit gjatë kohës së përgatitjes së detyrës gjatë të cilës duhet të realizojë së paku tre takime konsultuese me çdo nxënës veçmas
- Të drejtojë dhe sipas nevojës të ndihmojë nxënësin gjatë përpunimit të detyrës projektuese
- Të kryejë kontroll të dosjes së nxënësit për detyrë projektuese
- Të rishikojë detyrat projektuese të përgatitura dhe ti dërgojë apo kthejë detyrat projektuese në ripërpunim
- të marrë pjesë në punën e komisionit që vendos për ankesat e notave

Në fazën e parë (të përgatitjes)

- Ta formulojë temën në mënyrë precize
- Të vlerësojë nëse detyra e përzgjedhur a është në përputhje me aftësitë individuale të nxënësit në kohën e dhënies së saj
- Të ndihmojë nxënësin gjatë zgjedhjes së literaturës së përshtatshme e nevojshme për studim të problemit
- Të zgjedh metodologji të përshtatshme
- Të procesojë kushtet e nevojshme dhe ekzistuese në të cilat do të realizohet detyra projektuese (disponueshmëria e materialeve, burimeve, angazhimit).
- Mentori ka të drejtë notimi të kësaj faze

Në fazën e dytë (të realizimit)

- Të kontrollojë dosjen e nxënësit
- Të përcjellë dhe të ndihmojë që të mos devijojë nga tema, qëllimi dhe korniza metodologjike
- Të kontrollojë nëse nxënësi ka probleme në lidhje me kushtet e nevojshme dhe rrethanat e përpunimit të detyrës dhe të ndihmojë atë që ato ti zgjidhë
- Të kontrollojë nëse nxënësi po respekton afatet kohore për aktivitetet e parapara sipas planit
- të vlerësojë se sa nxënësi është i pavarur gjatë punës
- Të shënojë komentin e tij dhe rekomandimin për aktivitetet e mëtejshme në dosje të detyrës projektuese dhe të verifikojë me nënshkrimin e tij
- Të kërkojë nga nxënësi që të nënshkruhet
- Mentori ka të drejtë notimi të kësaj faze

Në fazën e tretë (të prezantimit)

- Bisedon me nxënësin për mënyrën e prezantimit të detyrës projektuese para komisionit të provimit (Të njejtën e vlerëson dhe jep udhëzime)
- I propozon nxënësit të bëjë prezantim provë (Të njejtën e vlerëson dhe jep udhëzime)
- Mentori nuk ka të drejtë notimi të kësaj faze.
- Mentori në këtë fazë me praninë e tij jep thjeshtë përkrahje morale nxënësit.
- Sipas nevojës mentori në këtë fazë jep informacione për sjelljen e nxënësit gjatë dy fazave të përpunimit të detyrës projektuese

Me qëllim që roli i mentorit të kryhet me sukses dhe cilësi, rekomandohet që çdo mësimdhënës-mentor të mos mentorojë mbi 30 nxënës.

7. DETYRAT DHE OBLIGIMET E NXËNËSIT

- Nxënësi ka të drejtë bazuar në pavarësinë, aftësitë individuale dhe afinitetet e tij të zgjedh temën e detyrës projektuese
- Ai është i obliguar të respektojë afatet kohore të përpunimit të detyrës projektuese (nga zgjedhja deri te realizimi); **nxënësi që nuk ia ka dhënë detyrën projektuese mentorit në afatin e paraparë, do të humb të drejtën të kalojë këtë pjesë të provimit**
- qartë e definon lëndën e hulumtimit
- Të vërtetojë nëse ka burime të mjaftueshme të informatave për pyetjen e hulumtimit
- Të verifikojë kushtet në të cilat do të realizohet hulumtimi/eksperimenti/punësia
- Të mbajë procesverbal (dosie-papke) në të cilën duhet të shënojë: aktivitetet e parapara me detyrën projektuese, vendin dhe kohën e realizimit të tyre, vërejtjet dhe udhëzimet e mësimdhënësit – mentor; të dhënat e rëndësishme, rezultatet e fituara (gjetjet) nga aktivitetet e kryera hulumtuese, informatat nga intervista, anketat, skicat, modelet provë etj.
- Të kryejë së paku (3) takime me mësimdhënësin-mentor.

8. NOTIMI I DETYRËS PROJEKTUESE

KRITERET E VLERËSIMIT TË DETYRËS PROJEKTUESE

1. Kriteret për notim të detyrës projektuese – ese

Niveli	Kriteret e notimit të fazës – përgatitjes (ESE)	Pikët
3	- Vetvetiu e përzgjedh temën bazuar në vëllimin e gjerë të literaturës së lexuar - qartë dhe në mënyrë precize e definon temën (e formulon pyetjen e hulumtimit) - përgatit plan të detajuar për detyrën projektuese në afatin e paraparë; - e njih metodologjinë e punës, tregon përgatitje dhe angazhim gjatë detyrës	3
2	- E zgjedh temën, por me ndihmën e mentorit - e definon temën (e formulon pyetjen e hulumtimit) por me ndihmën e mentorit - përgatit plan për detyrën projektuese në të cilën mungojnë elemente të caktuara - tregon mangësi të caktuara në zbatimin e metodologjisë së punës	2
1	- Temën ia ofron dhe definon mentorit - nuk shfrytëzon literaturë të mjaftueshme - përgatit plan me lëshime serioze - tregon mangësi serioze në metodologjinë e punës - tregon interes të ulët në detyrë	1
0	- Nuk e përzgjedh temën dhe nuk përgatit plan në afatin e paraparë - Nuk i referohet se ku dhe si do të kërkojë burime të informatave për detyrën - Nuk e njih metodologjinë e punës - Në përgjithësi nuk tregon interes për detyrën	0

Kriteret për vlerësimin e fazës – përpunim i esesë (ESE)				
Niveli	Gjuha	Struktura	Përshtatshmëria e përmbajtjes	Pikët
3	- Leksiku në ese është i pasur, i llojllojshëm dhe i përdorur me kujdes - ka gabime jo të dallueshme në të shkruar të fjalëve dhe shenjave të pikësimit - ka përdorim të përshtatshëm dhe të llojllojshëm të strukturave gramatikore me gabime jo të dallueshme	- Eseja i përmban pjesët strukturore (hyrje, pjesa kryesore dhe përfundimi) - Është e zhvilluar në mënyrë sistematike, idetë janë renditura në mënyrë logjike - janë të përdorura mjete të larmishme dhe të përshtatshme lidhëse (titulli, nëntitulli).	- Teksti përmban përgjigje të qarta, të rëndësishme, hyrëse dhe të argumentuara në pyetjen e hulumtuar - përmbajtja është e përshtatshme dhe në plotësi përgjigjet në detyrë - idetë në tekst janë të qarta, interpretimet janë të bazuara në të dhëna të rëndësishme dhe me qasje analitike	3
2	- Fjalori i esesë është i pasur, por me mospërpunje dhe gabime gjatë përdorimit të fjalive të përbëra - Hasen gabime në të shkruar dhe në shenja të pikësimit të cilat nuk e pengojnë të kuptuarit e mendimit - Strukturat gramatikore janë saktë të përdorura, por vërehen gabime gjatë përdorimit të strukturave të përbëra	- Teksti i përmban të gjitha pjesët strukturore (hyrjen, pjesën kryesore, përfundimin), por i mungon sistematizim i caktuar dhe logjik i lidhjes së ideve - Nuk ka mjete të përshtatshme lidhëse (titulli, nëntitulli)	- Teksti përmban argumente të qarta (i përgjigjet) pyetjes së hulumtimit - Përmbajtja i përgjigjet pyetjes së detyrës së dhënë - Idetë janë të qarta, por interpretimi është i bazuar në numër të pamjaftueshëm të informatave - mungon qasja analitike	2

1	- Leksiku është i kufizuar, por mundëson shprehjen e deklaratave themelore - janë bërë numër i madh i gabimeve në të shkruar të fjalëve dhe në përdorim të shenjave të pikësimit të cilat pengojnë në të kuptuarit e mendimit - janë të përdorura struktura gramatikore të thjeshta me gabime	- Tekstit i mungojnë elemente të caktuara strukturore dhe kompozimi - Teksti nuk ka sistematizim dhe lidhje logjike të ideve - përdorimi i pjesëve lidhëse është i kufizuar	- Eseja nuk i përgjigjet kërkesave të detyrës - Përgjigjet e pyetjes së hulumtimit bazohen në argumente jo të rëndësishme - idetë janë jo të qarta dhe përsëriten - teksti përmban informata jo të rëndësishme	1
0	- Leksiku është shumë i kufizuar, përmban numër të madh të gabimeve dhe nuk është i përshtatshëm në detyrën e caktuar - Janë bërë numër i madh i gabimeve në të shkruar të fjalëve dhe shenjave të pikësimit me çrast teksti është jo i kuptueshëm - janë përdorur strukturat gramatikore bazë me gabime elementare	- Teksti ka strukturë të paqartë - Idetë janë jologjike dhe teksti nuk ka kurfarë sistematizimi - mungojnë pjesët lidhëse	- Përmbajtja e esesë nuk përputhet aspak me kërkesat e detyrës - Idetë janë të paqarta - Teksti është konfuz dhe përmban informacione të papërshtatshme	0

*Kriteri **gjuhë** ndikon në notimi më së shumti kur nxënësit përpunojnë ese nga fusha e gjuhës maqedone, shqipe, turke, gjuhë e huaj

*Gjatë notimit të eseve nga fusha e sociologjisë, filozofisë, artit muzikorë, matematikë, sport, elementi leksikor, gramatikor dhe interpuksional i gjuhës nuk duhet të ketë ndikim të madh. Ajo që duhet të vlerësohet në kriterin-gjuhë është: të kuptuarit, vlerësimi dhe zbatimi i përshtatshëm i kuptimeve profesionale dhe termave.

Niveli	Kriteret e vlerësimit të fazës-prezantim (ESE)	Pikët
3	- prezantimi është i përgatitur qartë dhe me vizuelizim adekuat dhe në mënyrë efikase e shfrytëzon kohën - ka qëndrime të tij apo saj pro dhe kundër një këndvështrimi të caktuar në lidhje me temën - u përgjigjet pyetjeve në mënyrë korrekte, argumentuese dhe logjike - tregon shkallë të lartë të saktësisë në të folur dhe interpunksion (shenja pikësimi) gjatë të cilës shfaq komunikim të qartë dhe të kuptueshëm me bashkëbiseduesin/komisionin - gjatë prezantimit është i sigurtë dhe sistematik	3
2	- prezantimi është i përgatitur dhe mjaftueshëm i qartë që të ndiqet pa shumë vështirësi - idetë kryesore shpjegohen mjaftueshëm qartë - nxënësi i përgjigjet pyetjeve të bëra, por kërkon shpjegime shtesë (nënpjetje) nga komisioni - i mungon qartësia, sistematika dhe siguria gjatë prezantimit	2
1	- prezantimi është shumë i shkurtër dhe sipërfaqësor - nxënësi jep shpjegime të shkurtëra për përmbajtjen e temës - mund t'i përgjigjet një numri të kufizuar të pyetjeve (të shkurtëra dhe mjaft të qarta) - tregon pasiguri në prezantim	1
0	- prezantimi është i shkurtër dhe pa shpjegime në lidhje me përmbajtjen e temës - idetë kryesore janë të paqarta dhe prandaj inkurajohet vazhdimisht nga komisioni - jep përgjigje të pa argumentuar dhe jo logjike në pyetjet ose nuk përgjigjet fare	0

2. Kriteret për notimin e detyrës projektuese-raport nga hulumtimi eksperimental

Niveli	Kriteret e vlerësimit të fazës-përgatitje (HULUMTIM ESKPERIMENTAL)	Pikët
3	- Në mënyrë të pavarur dhe të përshtatshme e zgjedh një problem të caktuar - Formulon qartë dhe në mënyrë logjike një qëllim dhe hipotezë (nëse parashihen) - Bën në mënyrë të pavarur planin në të cilin renditen dhe përshkruhen të gjitha pjesët e nevojshme - Ka një skedar të plotë, të personalizuar me citime të përshtatshme të llojllojshme	3
2	- Zgjedh një problem me ndihmën e një mentori - Formulon qëllime dhe hipoteza (nëse parashihen) me ndihmën e mentorit - Bën në mënyrë të pavarur plan në të cilin renditen të gjitha pjesët e nevojshme - Ka skedarin e vet me tituj dhe burime homogjene	2
1	- Problemi ofrohet nga mentori - Formulon qëllim dhe hipoteza (nëse parashihen) por ato vendosen gabimisht - Bën plan por jo të plotë dhe nuk është i pavarur në punë - Ka dosjen e vet me burime dhe tituj të përshtatshëm	1
0	- Nuk zgjedh një problem kërkimor brenda afatit - Nuk tregon aspak interes për detyrën në fazën përgatitore - Nuk mund të bëjë një plan në mënyrë të pavarur, punon nën mentorim - Nuk ka paraqitur një plan brenda afatit - Nuk ka dosjen e vet	0

Niveli	Kriteret e vlerësimit të fazës-realizim (HULUMTIM ESKPERIMENTAL)	Pikët
3	- Në mënyrë të pavarur zgjedh dhe e realizon përpjekjen me metoda dhe teknika të përshtatshme - Në mënyrë të pavarur bën eksperimente, vëzhgon, mat dhe regjistron - Interpreteton në mënyrë korrekte dhe të pavarur të dhënat dhe vendos lidhjet e marrëdhëniet - Bën përfundimet të cilat kanë lidhje me qëllimin dhe hipotezat (nëse janë të parapara), ndërsa rrjedhin nga të dhënat - Tregimin e bën në mënyrë të pavarur - Tregimi i përmban të gjitha pjesët, me koment dhe lidhje themelore - Rrëfimi është estetikisht i rregulluar	3
2	- Zgjedh në mënyrë të pavarur eksperimente, teknika, metoda dhe paisje - Bën përpjekje, vëzhgon, mat dhe regjistron me ndihmën e herëpashershme të mentorit - Interpreteton të dhënat dhe pjesërisht vendos lidhje dhe marrëdhënie mes tyre - Ka përfundime, të cilat janë të përshtatshme për të dhënat, domethënë për qëllimin dhe hipotezat (nëse parashihen) - Tregimin e punon në mënyrë të pavarur - Tregimi i përmban të gjitha pjesët me komente të pjesshme	2
1	- Nuk është i pavarur në zgjidhjen e eksperimenteve, teknikave, metodave dhe paisjeve - Eksperimenton, vëzhgon, mat dhe regjistron, me ndihmë të shpeshtë - Interpreteton pjesërisht të dhënat dhe nuk krijon lidhje dhe marrëdhënie - Ka përfundime, por ato nuk janë plotësisht në përputhje me të dhënat - Tregimin e punon me ndihmë të herëpashershme - Tregimi i përmban të gjitha pjesët - Tregimi është pa formulim estetik	1
0	- Nuk mund të bëjë zgjedhjen e eksperimenteve, teknikave, metodave dhe paisjeve - Eksperimenton, vëzhgon, mat dhe regjistron, me praninë e vazhdueshme të mentorit - Nuk i interpreteton të dhënat dhe nuk krijon marrëdhënie - Nuk ka përfundime - Tregimin e punon me ndihmë të vazhdueshme - Prezantimi nuk i përmban të gjitha pjesët dhe nuk e dorëzon në afat të caktuar	0

Niveli	Kriteret e vlerësimit të fazës-prezantim (HULUMTIM ESKPERIMENTAL)	Pikët
3	- Ka përzgjedhje origjinale të formave, teknikave dhe paisjeve - Në mënyrë të pavarur i shfrytëzon teknikat dhe paisjet - Prezenton sipas rendit logjik - Rrjedhshëm dhe qartë bën argumentim, spjegim, krijon lidhje dhe marrëdhënie si dhe nxjerr përfundime - Tregimi përmban të gjitha pjesët sipas planit, me komente dhe lidhje të vendosura ndërmjet pjesëve individuale - Tregimi është origjinal dhe me formulim estetik	3
2	- Në mënyrë të pavarur zgjedh dhe përdor paisjet e duhura dhe teknikat e prezantimit - Prezanton qartë dhe sipas rendit logjik - Argumenton dhe nuk bën gabime - Tregimi përmban të gjitha pjesët me komente të pjesshme - Tregimi është estetikisht i këndshëm	2
1	- Zgjedh teknikat dhe paisjet me ndihmën e mentorit dhe prezanton në mënyrë pavarur - Riprodhon të dhëna pa spjegime - Argumenton dhe komenton si dhe nuk bën gabime - Tregimi i përmban të gjitha pjesët sipas planit - Nuk ka formulim estetik	1
0	- Përdor vetëm prezantim gojor - Nuk ka rend logjik në prezantim, bën gabime dhe është i hutuar - Tregimi nuk përmban të gjitha pjesët sipas planit	0

2. Kriteret për notimin e detyrës projektuese-raport nga hulumtimi empirik

Niveli	Kriteret e vlerësimit të fazës-përgatitje (HULUMTIM EMPIRIK)	Pikët
3	- Në mënyrë të pavarur e zgjedh temën - Në mënyrë të qartë i definon objektivat e temës (pyetjen e hulumtimit) - Përgatit plan të plotë dhe të detajuar - Është plotësisht i përgatitur në nevojat e literaturës specifike dhe burimeve të tjera të informatave	3
2	- Zgjedh në mënyrë të përshtatshme metodat dhe instrumentet e planifikuara të kërkimit - Zgjedh temën me ndihmën e mentorit - Shumica e qëllimeve janë qartë të definuara - Përgatit plan tërësor, por pa detaje të mjaftueshme - Është mjaftueshëm i përgatitur për nevojat e literaturës specifike dhe burimeve të tjera të informacionit - Shumicën e metodave dhe instrumenteve të planifikuara të hulumtimit janë përzgjedhur në mënyrë të pavarur dhe ashtu siç duhet	2
1	- Tema është ofruar dhe përcaktuar nga mentori - Shumica e qëllimeve nuk janë qartë të definuara - Përgatit plan jo të plotë - Është pjesërisht i përgatitur për nevojat e literaturës konkrete dhe burimeve të tjera të informacionit - Pjesë e vogël e metodave të planifikuara dhe instrumenteve të hulumtimit janë përzgjedhur në mënyrë të pavarur dhe ashtu siç duhet	1
0	- Nuk zgjedh temë në afatin e paraparë - Nuk përgatit plan në termin të përcaktuar apo nga plani i stërzgatur vërehet se nuk është i përgatitur në temën dhe nevojat e burimeve të informacionit - Nuk përzgjedh metoda dhe instrumente të hulumtimit	0

Niveli	Kriteret e vlerësimit të fazës-realizim (HULUMTIM EMPIRIK)	Pikët
3	- Të gjithë elementet strukturor janë zhvilluar siç duhet - Në mënyrë të vazhduar punon pavarur - Kupton plotësisht thelbin e temës - Është në gjendje të argumentojë, të përfundojë logjikisht, të mendojë në mënyrë kritike, të përdorë metodat dhe instrumentet mësimore të hulumtimit - Raporti dhe dokumentacioni i bashkëngjitur janë të përshtatshme dhe dorëzohen në afat të caktuar	3
2	- Shumica e elementeve strukturorë janë zhvilluar siç duhet - Zakonisht punon në mënyrë të pavarur - Kupton kryesisht thelbin e temës - Është i aftë për përdorim të pjesshëm të metodave dhe instrumenteve të planifikuara për hulumtim - Raporti dhe dokumentacioni i bashkëngjitur janë përgjithsisht të përshtatshme dhe të dorëzuara brenda afatit të caktuar	2
1	- Numër i vogël i elementeve strukturore janë zhvilluar siç duhet - Ka ide sipërfaqësore rreth thelbit të temës - Përdor metoda dhe instrumente për hulumtim vetëm me ndihmën e mentorit - Raporti është brenda afatit të bashkëngjitur por pa dokumentacion bashkëngjitur - Dorëzon dokumentacion pa raport ose dorëzon raport por proces jo	1
0	- Asnjë element strukturor nuk është zhvilluar siç duhet - Në mënyrë të vazhdueshme varet nga ndihma e mentorit - Nuk e kupton thelbin e temës - Nuk është në gjendje të përdorë metoda dhe instrumente kërkimore edhe me ndihmën e mentorit madje - Nuk ka plotësi	0

Niveli	Kriteret e vlerësimit të fazës-prezantim (HULUMTIM EMPIRIK)	Pikët
3	- Të gjitha elementet strukturorë janë zhvilluar siç duhet - Është plotësisht i përgatitur për prezantim (përdor vizuelizim adekuat) - Përdor kohën në mënyrë efikase, dallon të rëndësishmen nga e parëndësishmja - Kupton thelbin e temës, dmth përgjigjet në pyetjet e bëra dhe përdor arsyetim logjik - Kur prezanton është: i qartë, sistematik dhe i besueshëm	3
2	- Shumica e elementeve strukturorë janë zhvilluar siç duhet - Nuk është plotësisht i përgatitur për prezantim (ose përdor vizuelizim joadekuat) ose nuk zgjedh të rëndësishmet nga të pa rëndësishmet, ose nuk e respekton kornizën kohore - Kryesisht kupton thelbin e temës (përgjigjet në shumicën e pyetjeve të bëra) - Bën arsyetime logjike - Gjatë prezantimit ndonjëherë mungon: ose qartësia ose sistematizimi ose besueshmëria	2
1	- Një numër i vogël i elementeve strukturorë janë zhvilluar siç duhet - Nuk është përgatitur mjaftueshëm për prezantim (ose përdor vetëm vizuelizim adekuat) ose thjesht zgjedh të rëndësishmet nga të parëndësishmet, ose thjesht respekton kornizën kohore - Ka një ide sipërfaqësore të thelbit të temës, dmth rrallë jep përgjigje të arsyetuara logjikisht - Kur prezanton nuk është mjaftueshëm i qartë, sistematik dhe i besueshëm	1
0	- Asnjë element strukturor nuk është i zhvilluar si duhet - Nuk është gati për prezantim - Nuk e kupton thelbin e temës, dmth jep përgjigje të pa argumentuara dhe jo logjike, ose të pa përshtatshme fare - Gjatë prezantimit nuk është i qartë, nuk është sistematik, dhe nuk është i besueshëm	0

2. Kriteret për notimin e detyrës projektuese-prodhim/krijim

Niveli	Kriteret e vlerësimit të fazës-përgatitje (prodhim/krijim)	Pikët
3	- Në mënyrë të pavarur e zgjedh dhe e definon temën mbi bazën e burimeve të ndryshme të informacionit - Përgatit plan të detajuar dhe të plotë të punës	3
2	- Përzgjedh dhe definon temën, por me ndihmën e mentorit - Shfaq dobësi të caktuara në njohjen e metodologjisë së punës - Përgatit plan të punës, por i mungojnë detajet e caktuara	2
1	- Temën ia zgjedh dhe ia definon mentorit - Tregon dobësi serioze në njohjen e metodologjisë së punës - Përgatit plan të punës por me njohuri të dobëta	1
0	- Nuk përzgjedh temë në afatin e përcaktuar - Nuk përgatit plan deri në afatin e caktuar, apo përgatit plan nga i cili shihet se nuk i është referuar burimeve të nevojshme të informatave; nuk i ka definuar qartë qëllimet - nuk ka zgjedhur metoda dhe teknika të hulumtimit	0

Niveli	Kriteret e vlerësimit të fazës-realizim (prodhim/krijim)	Pikët
3	- Prodhimin/krijimin/ shërbimin e realizon sipas planit të përgatitur të punës - Ka performancë të qartë për atë se çka do të punojë - E njeh në tërësi procesin e realizimit të prodhimit/krijimit/shërbimit - përzgjedh materiale të përshtatshme për realizimin e prodhimit/krijimit/shërbimit - Përdor me shkathësi instrumente të përshtatshme, procedura dhe teknika të punës - punon në mënyrë të pavarur, është i angazhuar, tregon sjellje kreative në punë - është preciz dhe i përpiktë	3
2	- Prodhimin/krijimin/shërbimin e realizon sipas planit të përgatitur, me devijime të vogla - ka performancë të qartë për atë se çka do të punojë/realizojë - përzgjedh materiale të përshtatshme për përpunim/realizim të prodhimit/krijimit/shërbimit - e njeh procesin e përpunimit/realizimit të prodhimit/krijimit/shërbimit, por tregon pasiguri në punë	2
1	- shumë shpesh devijon nga plani i përgatitur për përpunimin e produktit (shërbimit) - zgjedh materiale jo të përshtatshme të punës - nuk ka performancë të qartë për produktin që e përpunon dhe nuk i njeh në tërësi proceset e përpunimit - zbaton procedura të thjeshta për përpunimin e produktit - shfrytëzon instrumente dhe teknika bazë të punës - rrallë punon në mënyrë të pavarur, nuk është preciz as i aftë për punë	1
0	- nuk performon saktë rreth produktit/krijimit që e përpunon dhe nuk e njeh procesin e përpunimit të tij (shërbimit) - nuk shfrytëzon instrumente të përshtatshme, procedura dhe teknika të punës - Në tërësi devijon nga plani i punës - Nuk bashkëpunon me mentorin	0

Niveli	Kriteret e vlerësimit të fazës-prezantim (prodhim/krijim)		Pikët
	Prodhim/krijim	Prezantim	
3	- Prodhimi/krijimi/shërbimi i realizuar është funksional dhe origjinal - Ai është i realizuar me shkallë të lartë të saktësisë, precizitetit, përpikmërisë dhe profesionalizmit - Te prodhimi/krijimi/shërbimi mund të notohen edhe karakteristika të tjera të rëndësishme për zonën ku bën pjesë detyra projektuese, si për shembull: dizajn, vlera estetike, shpejtësia, origjinaliteti i zgjidhjes, risia, ekonomizimi, aftësia etj. Sipas marrëveshjes me komisionin	- Është i përgatitur në plotni për prezantim (shfrytëzon vizuelizim adekuat - E prezenton thelbin e temës dhe pyetjet e parashtruara përgjigjet me argumente dhe bazë logjike - gjatë prezantimit është i qartë, sistematik dhe i sigurtë - krijon lidhje dhe marrëdhënie dhe nxjerr përfundime - e shfrytëzon në mënyrë efikase kohën	3
2	- Prodhimi/krijimi/shërbimi i realizuar është me mangësi të caktuara, saktësi, precizitet dhe përpikmëri të pjesshme	- Prezantimi është i përgatitur mirë, me vizuelizim të përshtatshëm, mungon sistematizimi i caktuar - I prezenton përfundimet, vlerëson, analizon, por nuk është mjaftueshëm i sigurtë dhe i qartë	2
1	- Prodhimi/krijimi/shërbimi i realizuar është jofunksional - Në strukturë/procedurë mungojnë pjesët e nevojshme - Kryen matje/përlllogaritje dhe llogaritje jo të sakta - Nuk e njeh teknologjinë e punës/procesin e dhënies së shërbimeve, teknikat dhe procedurat	- Prezantimi nuk është mjaftueshëm i menduar dhe i përgatitur, e paraqet me gojë pa përdorim të vizuelizimit, është jo i qartë dhe jo i kuptueshëm aq sa duhet - nuk ka kurfarë sistematizimi në interpretim - mund të përgjigjet vetëm në numër të kufizuar të pyetjeve	1
0	- Nuk realizon prodhim/krijim/shërbim	- Prezantimi nuk është i përgatitur, nuk është i qartë dhe është i pakuptueshëm	0

Kriteret dhe procedurat e notimit të detyrës projektuese

- Sa nxënësi e ka ndjekur metodologjinë e hulumtimit
- Sa me sukses e ka formuluar bazën e të dhënave dhe si i ka shfrytëzuar informatat
- Në çfarë mënyre e ka shënuar pjesën me shkrim të detyrës projektuese (strukturën, idenë, formën, gjuhën, përmbajtjen)
- Si e vendos subjektin e studimit/hulumtimit dhe si përgjigjet në të njëjtin
- Si i prezanton rezultatet/përfundimet
- Sa me sukses e realizon prezentimin me gojë

Notën përfundimtare nxënësi e merr si rezultat i

- notës që e merr nxënësi nga eseji/raporti nga hulumtimi/prodhimi i përgatitur/krijimi dhe
- notës nga prezatimi (mbrojtja) e detyrës projektuese përfshirë edhe përgjigjet në pyetjet e bëra nga ana e notesave të pavarur

Mentori e noton fazën e parë dhe dytë

Dy notuesit tjerë të komisionit e notojnë fazën e tretë.

ROLI I DY NOTUESËVE TË TJERË (ANËTARËVE TË KOMISIONIT)

Roli kryesor i dy notuesëve të tjerë është i rëndësishëm me theks të veçantë gjatë fazës së prezantimit

Notuesit duhet:

- Të posedojnë njohuri profesionale dhe pedagogjike
- Të jenë në gjendje të krijojnë atmosferë pune pa ndërprerje dhe tension
- Të lexojnë me vëmendje materialin e shënuar nga detyra projektuese e punuar
- Të njohin metodologjinë e punës kërkimore
- Të njohin procedurat e provimit dhe kriteret e notimit të detyrës projektuese
- Të mos e ndërpresin nxënësin derisa ai e prezanton detyrën projektuese , vetëm nëse për një gjë të tillë ka nevojë (nxënësi nuk ka qenë mjaftueshëm i qartë në prezantim dhe të ngajshme)
- Të parashtrojnë pyetje korrekte dhe stimulative ndaj nxënësit
- Të respektojnë kohën e paraparë për dhënien e detyrës projektuese (20 min përfshirë pyetjet dhe përgjigjet)